

VENDIM
Nr. 449, datë 22.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMN
NR. 1240, DATË 10.9.2008, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË BASHKISË
POGRADEC, TË QARKUT TË KORÇËS”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë për Bashkinë Pogradec dhe heqjen nga lista që i bashkëlidhet vendimit nr. 1240, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të pronave me numër rendor 149 dhe 151, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror:				Identifikat: <i>Altin Zhobro</i>						
Bashkia / Komuna : Pogradec				Supervizor: <i>Aliq Memaj</i>						
Fusha e perdorimit te Prones: Administrative e Qarkut				Aprovat: <i>Mangalina Cane (Kryetare e Bashkise)</i>						
Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
147				Zyra Qendrore e Gjendjes Civile Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Administrata	Prefektura Korçe	Zyra e Gjendjes Civile Pogradec	Ka dy ambiente ne katin perdhe ne ndertesen e Bashkise
148				Zyrat e Administrimit te tokes bujq. Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Administrata	Qarku Korçe	Zyra e Adm. Tokes. Bujq Pogradec	Ka dy ambiente ne katin e pare ne ndertesen e Bashkise
149				Zyra e Sekretarit te Deputetit Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Zyre pritje	Deputeti I Zones	Deputeti I Zones nr. 85	Ka nje ambient ne katin e dyte ne ndertesen e Bashkise
150				Zyra e te Derguarit te Prefektit Lagje Nr. 2 Rr. "Rreshit Çollaku" Bashkia Pogradec			Zyre pritje	Prefektura Korçe	Nenprefekti Pogradec	Ka nje ambient ne katin e dyte ne ndertesen e Bashkise
151				Dhome Pritje e Deputetit per zonen Nr. 84. L. Nr. 2 "Rr. Çollaku" Bashkia Pogradec			Zyre Pritje	Deputeti I Zones	Deputeti I Zones nr. 84	Ka dy ambiente ne katin e dyte ne ndertesen e Bashkise dhe nje wc